

Rekomandime



Siguria dhe shëndeti në punë

Rregulloret e sigurisë në punë dhe zbatimi i tyre



- Promovimi i mjeteve elektronike, si digjitalizimi i listave kontrolluese dhe lehtësimit i qasjes në kërkesat e rregulloreve
- Përdorimi i një programi ose faqeje web si OiRA mund të integrojë në mënyrë elektronike të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP), duke lehtësuar qasjen për të gjithë për informacionin e duhur për SSHP.
- Orientim në fushën e bujqësisë në të gjitha aspektet, duke hartuar rregullore, udhëzueseve dhe mjeteve tjera informuese për këtë sektor.
- Ndarja e inspektorëve të punës në dy grupe: për çështjet e punës (të kenë kualifikim juridik) si dhe për siguri dhe shëndet në punë (të kenë kualifikimet teknike).
- Trajnime të veçanta për Inspektorët e rinj të punës, si dhe planifikimi i programit për fazën provuese ku ata mbikëqyren nga një inspektor i punës me përvojë
- Qasje më konstruktive e Inspektoratit të Punës, në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e punëdhënëseve.

- Analizimi i gjendjes ekzistuese të shëndetit mendor dhe mirëqenies në vendet e punës, përmes pyetësorëve/anketave të ndryshme.
- Promovimi përmes kampanjave të ndryshme për ndërgjegjësim dhe vetëdijesim, si dhe zhvillimi i udhëzuesve të ndryshëm.
- Hartimi i politikave të përcaktuara në planifikime afat-mesme për ngritjen e kapaciteteve të mjekësisë së punës.
- Kontrollë mjekësore në vendin e punës në përputhje me ligjin, si dhe Ministria përkatëse të hartoj dhe aprovoj listën e sëmundjeve profesionale.

Promovimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies në vendin e punës



Strategjitë për parandalimin e aksidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës



- Aprovimi i strategjisë për siguri dhe shëndet në punë.
- Rregullimi i përfitimeve të punëtorëve të aksidentuar në vendin e punës apo kompensimet e aksidenteve në vendin e punës.
- Hartimi i rregulloreve, manualeve, proceseve, procedurave dhe udhëzuesve për hetimin e incidenteve dhe aksidenteve në vendin e punës.
- Identifikimi i rreziqeve, trajnimet e punëtorëve, sigurimi i pajisjeve mbrojtëse dhe përfshirja e punëtorëve, për të promovuar sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës. Masat duhet të jenë pjesë e një plani korigjues/parandalues.
- Krijimi i sistemit kombëtar informativ për siguri dhe shëndet në punë (duke përfshirë të gjitha të dhënat dhe statistikat në aspektet e SSHP-së).
- Rritja e bashkëpunimit rajonal si komponentë kryesore në fushën e SSHP-së.